

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ ANA 2001 ” Sh.p.k.



Sot më datë 24.05.2011 ne ortaket :

- **Suzana Banushaj**, qytetare shqiptare, e bija e Bino, lindur në Armen, Vlore , më 01.02.1964, banues në lagjen Pavaresia Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 027964186, leshuar me date 03.12.2009.
- **Shpresa Driza** , qytetare shqiptare, e bija e Bino, lindur në Armen, Vlore , më 05.02.1959, banues në lagjen Isa Boletini Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 024735043, leshuar me date 28.03.2009.
- **Shpresa Haxhiraj** , qytetare shqiptare, e bija e Fejzi , lindur në peshtan i Vogël Fier, më 28.10.1974, banues në lagjen 28 Nentori Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 025296060, leshuar me date 07.05.2009.

Kemi vendosur të nënshkruajmë Statutin e ndryshuar të shoqërisë „ ANA 2001„ shpk, i cili rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ligji 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 1 – Forma dhe Ortaket

- 1.1. Shoqëria „ ANA 2001, shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është „ ANA 2001„ shpk,.

Neni 3 – Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1. Shoqëria ka si objekt veprimtarie: Eksport,import, tregti me shumice e pakice të artikujve të ndryshëm, industrial, ushqimor, materiale të ndryshme ndërtimi , hidrosanitare, elektrike, elektronike e elektroshtepiak, kancelari, tekstile, bizhuteri, prodhime kimike, kozmetike, detergjente, pjesë për makina, , veprimtari në fushën e shërbimeve , hapje shtypshkronje, transport të mallrave e udhëtareve , vajra , pjesë ndërrimi, mobilie dhe pajisje zyrtare. Hapje, Bar, restorante, piceri e hoteleri dhe shfrytëzimi i tyre .

SHTYPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE

2. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë edhe gjithë ato aktivitete të cilat në mënyrë direkte apo indirekte përputhen me objektin e mësipërm.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në lagjen Kushtrimi Vlore, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj, kudo ku ka aktivitet shoqëria „ ANA 2001 „ shpk .

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pacaktuar mbi njezete vjet.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000, 00 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, me vlerë nominale 1.000.00 (njemijë) lekë.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:
- **Z. Suzana Banushaj** ka një kontribut në para të barabartë me **1ekë 33000** (tridhjetë e tre mijë) leke.
 - **Z. Shpresa Driza** , ka një kontribut në para të barabartë me **33000** (tridhjetë e tre mijë) leke.
 - **Z. Shpresa Haxhiraj** ka një kontribut në para të barabartë me **34000** (tridhjetë e katër mijë) leke.
- 7.2. Sipas kontributeve të mësipërme:
- Z. Suzana Banushaj** i përkasin 33.00 (tridhjetë e tre) pjesë, që i korrespondojnë 33.00% (tridhjetë e tre përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.



SHTVPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE

Z. Shpresa Driza i përkasin 33.00 (tridhjetë e tre) pjesë, që i korrespondojnë 33.00% (tridhjetë e tre përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Z. Shpresa Haxhiraj i përkasin 34.00 (tridhjetë e katër) pjesë, që i korrespondojnë 34.00% (tridhjetë e katër përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar


- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblese.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblese.

Neni 10 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 10.1 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas nenit 73 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 10.2 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortaku tjetër gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, çmimin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letër rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë më pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të



SHTVPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORË

drejtën e parablerjes.

- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katrat) e kapitalit themeltar.
- 10.7 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk japin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katrat) e kapitalit themeltar.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Vendimet e Asamblesë se Zakonshme. për të cilat kërkohej një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë të paktën 30% (tridhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë se Jashtezakonshme. për të cilat kërkohej një shumicë e kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë të paktën 50% (pesdhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar.
- 11.3 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 11.2 të këtij statuti, Asambleja do të mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 11.4 Asambleja e Jashtezakonshme vendos me shumicë të kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ të votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me ndryshimin e statutit, rritjen dhe zvogelimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e Shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, përveç sa është parashikuar në ligj dhe në statut, Asambleja vendos në mbledhjen e zakonshme me votën e shumicës së ortakëve të pranishëm.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

SHTVPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël sidhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 5% (pese per qind) te kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtate) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Itali ose në Shqipëri.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Asambleja vendos mbi ndryshimet në Statut me votën *pro* të ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 13.8 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga 1(një) Administrator ortakët kanë zgjedhur si të tillë Z. **Suzana Banushaj** i cili do të qëndrojë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej **5 (pese) vjetesh**.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit .
- 14.3 Administratori mund të emëroj përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.



SHTVPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VZORE

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Asambleja e Ortakëve, ka caktuar ekspertin kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e percaktuar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.3 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet


- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.



SHTVPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE



Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personalc apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore.

ORTAKET E SHOQERISE

SUZANA BANUSHAJ

Suzana Banushaj

SHPRESA DRIZA

Shpresa Driza

SHPRESA HAXHIRAJ

Shpresa Haxhira

SHTYPSHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE



Taksa e pulles u aplikua ne kopjen e noterit 200 leke .

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE
NOTERE SAIMIRA HOXHA

Vlore me 24.05.2011
Rep. 653
Kol 613/1

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 24.05.2011 u paraqit para meje Noteres se rrethit VLORE ,Saimira Hoxha ,personalisht shtetaset shqiptare :

- **Suzana Banushaj**, qytetare shqiptare, e bija e Bino, lindur në Armen, Vlore , më 01.02.1964, banues në lagjen Pavaresia Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 027964186, leshuar me date 03.12.2009.
- **Shpresa Driza** , qytetare shqiptare, e bija e Bino, lindur në Armen, Vlore , më 05.02.1959, banues në lagjen Isa Boletini Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 024735043, leshuar me date 28.03.2009.
- **Shpresa Haxhiraj** , qytetare shqiptare, e bija e Fejzi , lindur në Peshtan i Vogel Fier, më 28.10.1974, banues në lagjen 28 Nentori Vlore, Shqipëri, me Leternjoftim ID me Nr 025296060, leshuar me date 07.05.2009.

Te cilat me vullnet te lire dhe me deshiren e plote te tyre me deklaruan se kane nënshkruar Statutin e ndryshuar te shoqerise „ ANA 2001„ shpk, i cili rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ligji 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Une Noterja pasi e gjej aktin e sipershenuar konform vullnetit te kerkuesve e legalizoj ate dhe e vertetoj rregullisht konform ligjit .

NOTERE
SAIMIRA HOXHA

SHKURTYP SHKRONJA
"ANA - 2001"
VLORE